



Pranuar / Dorezuar Pitiljen/Prodato Received/Delivery	26.12.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHCK	7653	/2023	1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1418/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi -Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.1418/2023 e datës 15.11.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adrese banim rruga [redacted] Komuna e Pejës, kundër organi të punësimit Komuna e Pejës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 26.12.2023, mori këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.1418/2023 e datës 15.11.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

(tani e tutje referuar si ankuesi), me datë 15.11.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të regjistruar nën shenjen A.nr. 1418/2023 me numër protokolli 6988/2023, me pretendimin lidhur me kompensimin e shumë prej 30%, të pagës bazë për orë të plotë për punë jashtë orarit të rregullt të punës dhe gjatë ditëve të punës dhe ditëve të vikendit sipas Vendimit me numër protokolli Nr. 01/112/02-109581, të datës 10.08.2021 të Kryetarit të Komunës së Pejës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Pejës ndërsa me datë 01.12.2023, nga kjo e fundit ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje referuar si Kolegji i këshillit), pas shqyrtimit të përmbajtjes së objektit të ankesës si dhe të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë të dërguara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pajuar, sepse:

Kolegji i këshillit, ka konstatuar se ankuesi bazuar në aktemrimin A.nr.724/2022 të datës 12.10.2022 mbanë pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Informim" në Komunë të Pejës, ndërsa i njëjti pretendon se sipas vendimit me numër protokollit 01-112/02-109581/2021, të datës 10.08.2021, të Kryetarit të Komunës së Pejës, me që rast ankuesit i janë caktuar disa detyra shtesë, përkatësisht „Zyrtar Përgjegjës për Menaxhimin e Platformës së Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e Zbatimit të Standardeve Minimale të Konsultimit Publik në Komunën e Pejës“, pranë zyrës së Kryetarit të Komunës, njëkohësisht sipas këtij vendimi i është njohur e drejta e kompensimit për punë shtesë jashtë orarit të punës me kompensim 30%, të pagës bazë për orë të plotë për punë jashtë orarit të rregullt të punës dhe gjatë ditëve të punës dhe ditëve të vikendit, ndërsa i njëjti vendim është shfuqizuar përmes vendimit me numër protokollit 112/02-79243/2023, të datës 14.08.2023, ndaj të cilit nuk ka ndonjë ankesë.

Kolegji i këshillit referuar vendimeve të apostrofuara më lartë konstaton se ankuesi ka pretendimin për kompensimin 30% të pagës bazë për orë të plotë për punë jashtë orarit të rregullt të punës dhe gjatë ditëve të punës dhe ditëve të vikendit, duke përfshi periudhën prej kohës së apostrofuara në vendimin numër protokollit 01-112/02-109581/2021 të datës 10.08.2021 e deri në shfuqizimin e këtij vendimi që ka ndodhë më datë 14.08.2023, nga i njëjti organ që ka nxjerrë këtë vendim, e që u potencue më lartë, andaj referuar bazës ligjore që ndërlidhet me këtë çështje kontestuese ka marrë për bazë me rastin e vendimmarrjes dispozitat e Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe bazuar në dispozitat e këtij ligji Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh të përcaktuar me dispozitat e nenit 127, paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ" dhe "4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", si dhe në kundërshtim me nenin 24, paragrafi 3 Ligjit nr. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; "3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...." prandaj bazuar në bazën ligjore si më lartë si dhe përmbajtjen e vendimeve që ndërlidhen me këtë çështje, konstatohet se ankesa është parashtruar në këshill jashtë afatit ligjor të parashikuar në legjislacionin përkatës dhe që u apostrofua më lart.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1418/2023, datë 26/12/2023

Rushit Kajtazi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

